REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
**SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR**
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.__773/1__Prot                                        Tiranë, më 15/05/2026

**Lënda:** Dërgohen raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për 4 - mujorin e parë të vitit 2026.

**DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**TIRANË**

Në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 3891 Prot, datë 05.05.2026, "Mbi p*regatitjen e raportit të monitorimit për zbatimin e buxhetit"për 4 mujorin e parë të vitit 2026* ", bashkëlidhur shkresës po ju dërgojmë:
Raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për 4 - mujorin e parë të vitit 2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Adrian BYLYKU

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**
**ZËVENDËS DREJTOR I PËRGJITHSHËM**
**E**
**DREJTOR I PROGRAMIM ZHVILLIMIT**

Rudina BANUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Konceptoi: Diturie Balla    Përgj .Sekt .Financës,Buxhetit dhe Burime Njerzore
Miratoi: Nafie.Gjapi    Dr e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Periudha e Raportimit 4-2026

# ANEKSI nr.3 Raporti i performancës së produkteve të programit

në/lekë

| Emri i Grupit | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Kodi i grupit | 06 |
|---|---|---|---|
| Emri i | Mbështetje për Burimet Natyrore | Kodi i programit | 04430 |

| Kodi i Produktit | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Viti paraardhës | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Deviacioni i Kostos për Njësi | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Sasia Faktike (Viti paraardhës) | Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhes) | Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës) | Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) | Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor | Kosto për Njësi (sipas planit Fillestar të vitit | Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent) | Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent) | Kosto për Njësi(sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent) | Sasia Faktike (në /nfund të vitit korent) | Shpenzimet Faktike /n(në fund të vitit korent) | Kosto për Njësi Faktike n/(në fund të vitit korent) | 13=(12)-(3) | 14=(12)-(6) | 15=(12)-(9) |
| | | | (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) | (7) | (8) | (9) | (10) | (11) | (12) | (13) | (14) | (15) |
| **Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit** | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar | Numër punonjësish | 108 | 204,229,949 | 1,645,916 | 125 | 234,370,000 | 1,874,960 | 126 | 234,970,000 | 1,864,841 | 105 | 63,891,064 | 608,486 | (1,037,430) | (1,266,474) | (1,256,355) |
| 25AG801 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune për Laboratorin e SHGJSH (kontratë e vitit 2025) | cope | 0 | 0 | 0 | 4 | 2,971,200 | 742,800 | 4 | 2,971,200 | 742,800 | 4 | 2,971,200 | 742,800 | 742,800 | - | - |
| 25AG802 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të SHGJSH | cope | 0 | 0 | 0 | 8 | 5,028,800 | 628,600 | 8 | 5,028,800 | 628,600 | 0 | 0 | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 25AG803 | Blerje paisje kompjuterike për nevoja të SHGJSH | cope | 0 | 0 | 0 | 12 | 2,000,000 | 166,667 | 12 | 2,000,000 | 166,667 | 0 | 0 | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! |
| T | Total buxheti | | 0 | 0 | | | 244,370,000 | | | 244,970,000 | | | 66,862,264 | #DIV/0! | | | |
| **Produktet e realizuara me shpenzimet nga financimi i huaj** | | | | | | | | | | | | | | | | | - |
| 25AD501 | Pojekti AIMS ( Financim I huaj) | cope | 0 | 0 | 0 | 3 | 5,985,676 | 1,995,225 | 3 | 5,985,676 | 1,995,225 | | | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 25AD502 | Pojekti Rispect (Financim I huaj)Skema Rajonale të inovacionit për kapacitete dhe teknologjitë e kërkim zbulimit (ShGjSh) | cope | 0 | 0 | 0 | 10 | 11,508,324 | 1,150,832 | 10 | 11,508,324 | 1,150,832 | | | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06)** | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar | Numër punonjësish | 20 | 2,660,598 | 133,030 | 20 | 5,092,971 | | 20 | 5,092,971 | 254,649 | 20 | 738,801 | 36,940 | - | 36,940 | (217,709) |
| 19AH805 | Blerje paisje pune e pajisje profesionale | cope | 6 | 2,650,656 | 441,776 | 1 | 5,228,816 | | 1 | 5,228,816 | 5,228,816 | 0 | 0 | #DIV/0! | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| T | Total jashte limitit | | | 5,311,254 | | | 10,321,787 | 0 | | 10,321,787 | | | 738,801 | | | | |

| Drejtori i Drejtorisë së Financës e Sherbimeve Mbështetëse | Emri | Nafie Gjapi |
|---|---|---|
| | Firma | |
| | Data | 13.05.2026 |

| Drejtori i Përgjithshëm | Emri | Adrian Bylyku |
|---|---|---|
| | Firma | |
| | Data | 13.05.2026 |

## SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR

### Aneksi 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve

**Periudha e Raportimit 4-2026**

| Kodi i Ministrisë | Kodi i Programit | Emërtimi i Programit | Kodi I Produktit | Emërtimi i Produktit | Tipi i Buxhetit | Sasia | Total | Artikujt buxhetore 230 Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara | 231 Shpenzime Kapitale të Trupëzuara | 600 Pagat | 601 Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore | 602 Mallra dhe Shërbime | 604 Të Tjera Transfer.Korrente Brendshme | 605 Transfer. Korrente të Huaja | 606 Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | I. | *Shpenzime buxhetore (kapitulli 01+kapitulli 05)* | | | | | | | | | | | |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sh Gj Sh | Plani fillestar | 125 | 234,370,000 | 0 | 0 | 169,350,000 | 28,220,000 | 35,720,000 | 0 | 1,000,000 | 80,000 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sh Gj Sh | Plani i rishikuar | 125 | 234,970,000 | 0 | 0 | 169,350,000 | 28,220,000 | 35,720,000 | 0 | 1,000,000 | 680,000 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sh Gj Sh | Fakti | 105 | 63,891,064 | 0 | 0 | 48,474,485 | 7,955,242 | 6,268,778 | 0 | 999,943 | 192,616 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG801 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune për Laboratorin e SHGJSH (kontratë e vitit 2025) | Plani fillestar | 1 | 2,971,200 | 0 | 2,971,200 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG801 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune për Laboratorin e SHGJSH (kontratë e vitit 2025) | Plani i rishikuar | 1 | 2,971,200 | 0 | 2,971,200 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG801 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune për Laboratorin e SHGJSH (kontratë e vitit 2025) | Fakti | 1 | 2,971,200 | 0 | 2,971,200 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG802 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të SHGJSH | Plani fillestar | 8 | 5,028,800 | 0 | 5,028,800 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG802 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të SHGJSH | Plani i rishikuar | 8 | 5,028,800 | 0 | 5,028,800 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG802 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të SHGJSH | Fakti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG803 | Blerje paisje kompjuterike për nevoja të SHGJSH | Plani fillestar | 12 | 2,000,000 | 0 | 2,000,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG803 | Blerje paisje kompjuterike për nevoja të SHGJSH | Plani i rishikuar | 12 | 2,000,000 | 0 | 2,000,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AG803 | Blerje paisje kompjuterike për nevoja të SHGJSH | Fakti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | **Totali i shpenzime buxhetore** | **Plani fillestar** | | **244,370,000** | **0** | **10,000,000** | **169,350,000** | **28,220,000** | **35,720,000** | **0** | **1,000,000** | **80,000** |
| | | | | **Totali i shpenzime buxhetore** | **Plani i rishikuar** | | **244,970,000** | **0** | **10,000,000** | **169,350,000** | **28,220,000** | **35,720,000** | **0** | **1,000,000** | **680,000** |
| | | | | **Totali i shpenzime buxhetore** | **Fakti** | | **66,862,264** | **0** | **2,971,200** | **48,474,485** | **7,955,242** | **6,268,778** | **0** | **999,943** | **192,616** |
| | | | II. | *Shpenzimet nga financimi i huaj (Kapitulli 02)* | | | | | | | | | | | |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AD501 | Pojekti AIMS ( Financim I huaj) | Plani fillestar | 3 | 5,985,676 | 0 | 5,985,676 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AD501 | Pojekti AIMS ( Financim I huaj) | Plani i rishikuar | 3 | 5,985,676 | 0 | 5,985,676 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AD501 | Pojekti AIMS ( Financim I huaj) | Fakti | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AD502 | Pojekti Rispect (Financim I huaj)Skema Rajonale të inovacionit për kapacitete dhe teknologjitë e kërkim zbulimit | Plani fillestar | 10 | 11,508,324 | 0 | 11,508,324 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AD502 | Pojekti Rispect (Financim I huaj)Skema Rajonale të inovacionit për kapacitete dhe teknologjitë e kërkim zbulimit | Plani i rishikuar | 10 | 11,508,324 | 0 | 11,508,324 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 25AD502 | Pojekti Rispect (Financim I huaj)Skema Rajonale të inovacionit për kapacitete dhe teknologjitë e kërkim zbulimit | Fakti | 10 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | **Total financimi i huaj** | Plani fillestar | | **17,494,000** | **0** | **17,494,000** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| | | | | **Total financimi i huaj** | Plani i rishikuar | | **17,494,000** | **0** | **17,494,000** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| | | | | **Total financimi i huaj** | Fakti | | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| | | | III. | *Shpenzime nga te ardhurat jashte limitit (Kapitulli 06)* | | | | | | | | | | | |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sh Gj Sh | Plani Thesari | | 5,092,971 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5,092,971 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sh Gj Sh | Fakti | | 738,801 | 0 | 0 | 0 | 0 | 738,801 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 19AH805 | Blerje paisje pune e pajisje profesionale | Plani Thesari | | 5,228,816 | 5,228,816 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 06 | 04430 | Mbështetje për Burimet Natyrore | 19AH805 | Blerje paisje pune e pajisje profesionale | Fakti | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | **Totali i shpenz nga të Ardhura jashte limitit** | Plani Thesari | | **10,321,787** | **5,228,816** | **0** | **0** | **0** | **5,092,971** | **0** | **0** | **0** |
| | | | | **Totali i shpenz nga të Ardhura jashte limitit** | Fakti | | **738,801** | **0** | **0** | **0** | **0** | **738,801** | **0** | **0** | **0** |

| | | |
|---|---|---|
| Drejtori i Drejtorisë së Financës e Sherbimeve Mbështetëse | Emri | Nafie Gjapi |
| | Firma | |
| | Data | 13.05.2026 |

| | | |
|---|---|---|
| Drejtori i Përgjithshëm | Emri | Adrian Bylyku |
| | Firma | |
| | Data | 13.05.2026 |

# ANEKSI nr.4 Raporti i realizimit të treguesve të performances së programit

Periudha e Raportimit 4-2026

| Emri i Grupit | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Kodi i Grupit | 06 |
|---|---|---|---|
| Emri i Programit | Mbështetje për Burimet Natyrore | Kodi i Programit | 04430 |
| Qëllimi i politikës së programit | "Realizimi i politikave të promovimit, mbikqyrjes, monitorimit dhe transparences ne fushen e gjeologjise, minierave, ambientit, ujerave. " | | |

| Treguesit e performancës në nivel qëllimi | | Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi i treguesit | Emërtimi i treguesit | Tregues me bazë gjinore ( PO ) | Njësia matese | Fakti i Vitit Paraardhës | Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2026 | Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2026 | Fakti i Periudhës/progresive | Ndryshimi (Plan - Fakt) | % e realizimit |
| **Objektivat e politikës së programit** | | | | | | | | | |
| | Objektivi: Promovimi i burimeve hidrologjike dhe minerare të pashfrytëzuara.. | | | | | | | | |
| | Studime mbi burimeve hidrologjike dhe minerare të pashfrytëzuara dhe parandalimin e rreziqeve gjeologo - mjedisore nëpërmjet monitorimit | | | | | | | | |
| **Produktet** | | | | | | | | | |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar | | Numër punonjësish | 108 | 125 | 125 | 105 | 20 | |
| | Administrate funksionale per aktivitetin e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar | | lekë | 204,229,949 | 234370000 | 234,970,000 | 63,891,064 | 171,078,936 | 27.19 |
| 25AG801 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune për Laboratorin e SHGJSH (kontratë e vitit 2025) | | cope | 0 | 4 | 4 | 4 | 0 | 0 |
| 25AG801 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune për Laboratorin e SHGJSH (kontratë e vitit 2025) | | lekë | 0 | 2,971,200 | 2,971,200 | 2,971,200 | 0 | 100.00 |
| 25AG802 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të SHGJSH | | cope | | 8 | 8 | 0 | 8 | |
| 25AG802 | Blerje aparatura e pajisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të SHGJSH | | lekë | | 5,028,800 | 5,028,800 | 0 | 5,028,800 | 0.00 |
| 25AG803 | Blerje paisje kompjuterike për nevoja të SHGJSH | | cope | | 12 | 12 | 0 | 12 | |
| 25AG803 | Blerje paisje kompjuterike për nevoja të SHGJSH | | lekë | 0 | 2,000,000 | 2,000,000 | 0 | 2,000,000 | 0.00 |
| 25AD501 | Pojekti AIMS (Financim I huaj) | | Numër punonjësish | 0 | 3 | 3 | 0 | 3 | |
| 25AD501 | Pojekti AIMS (Financim I huaj) | | lekë | 0 | 5,985,676 | 5,985,676 | 0 | 5,985,676 | 0.00 |
| 25AD502 | Pojekti Rispect (Financim I huaj)Skema Rajonale të inovacionit për kapacitete dhe teknologjitë e kërkim zbulimit (ShGjSh) | | Numër punonjësish | 0 | 10 | 10 | 0 | 10 | |
| 25AD502 | Pojekti Rispect (Financim I huaj)Skema Rajonale të inovacionit për kapacitete dhe teknologjitë e kërkim zbulimit (ShGjSh) | | lekë | 0 | 11,508,324 | 11,508,324 | 0 | 11,508,324 | 0.00 |
| | **Totali buxheti Shërbimi Gjeologjik Shqiptar** | | **lekë** | **204,229,949** | **261,864,000** | **262,464,000** | **66,862,264** | **195,601,736** | **25.47** |

| Drejtori i Drejtorisë së Financës e Sherbimeve Mbështetëse | Emri | Nafie Gjapi | |
|---|---|---|---|
| | Firma | | |
| | Data | 13.05.2026 | |

| Drejtori i Përgjithshëm | Emri | Adrian Bylyku |
|---|---|---|
| | Firma | |
| | Data | 13.05.2026 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

# Raport i monitorimit të buxhetit për 4 mujorin (Janar-Prill) 2026

- Përmbjajtja e raportit të monitorimit të buxhetit

Raporti i monitorimit të buxhetit përmban:

- Hyrja
- Informacioni buxhetor i agrergruar.
- Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore në nivel produkti.
- Performanca e buxhetit në nivelin e programit.
- Projektet kapitale
- Ndryshimet në buxhet (Kërkesat emergjente të institucionit për fonde)
- Përfundime

## - <u>Hyrja</u>

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar funksionin sipas Ligjit Nr. 115/2015 datë 15/10/2015 "*Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*" dhe është institucion këshillimor, teknik dhe shkencor i shtetit, person juridik publik, buxhetor, i cili kryen veprimtari në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Objektivi kryesor është angazhimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh) në shërbime të rëndësishme për ekonominë kombëtare në fushën e gjeoshkencave, në zbatim të Programeve të Qeverisë; Ligjit për ShGjSh-në; Ligjit Minerar; Ligjit për "Mbrojtjen e Mjedisit"; Ligjit "Për Menaxhimin e Integruar të Ujrave"; VKM "Për Rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit; Ligjit "Për Urbanistikën"; VKM "Për miratimin e Rregullores së Urbanistikës"; Ligjit "Për Emergjencat Civile"; etj. Këto shërbime janë me porosi të shtetit ose të të tretëve, në fushën e shkencave të tokës në të gjithë territorin e vendit.

## - <u>Informacioni buxhetor i agrergruar.</u>

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është institucion publik buxhetor në varësi të MIE.

Buxheti i planifikuar për vitin 2026 për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar është dërguar me shkresat e MIE:

- nr. 73/14 prot, datë 21.01.2026 *"Dërgohet miratimi i detajimit të planit të buxhetit për shpenzimet korente për vitet 2026-2028"* .

- nr. 137/4 prot, datë 25.03.2026 *"Dërgohet miratimi i detajimit të buxhetit për shpenzimet kapitale për vitet 2026-2028 "* .

Gjatë vitit 2026 kemi patur këto ndryshime në buxhetin e miratuar:

- Shtimi i shpenzimeve të planifikuara si fond i veçantë në shumën 600.000 lekë, dërguar me shkresën e MIE me nr. 821/12 prot, datë 19.02.2026 *"Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të vecantë për vitin 2026"*.

Shpenzimet e planifikuara sipas shkresave të mësipërme dhe plani i rishikuar i shpenzimeve per vitin 2026 sipas ndryshimeve të mësipërme është si më poshtë:

| Ministria e Linjës | Kodi i Intsitucionit | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi i Thesarit | Kodi i produktit / projektit të investimeve | Buxheti fillestar 2026 | Buxheti i rishikuar 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***I. SHPENZIME KORENTE*** | | | | | | | | |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 6000000 | 3535 | 90603AA | 164,950,000 | 164,950,000 |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 6010000 | 3535 | 90603AA | 4,400,000 | 4,400,000 |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 6020000 | 3535 | 90603AA | 27,470,000 | 27,470,000 |
| 06 | 1006156 | 05 | 4430 | 6000000 | 3535 | 90603AA | 750,000 | 750,000 |
| 06 | 1006156 | 05 | 4430 | 6010000 | 3535 | 90603AA | 33,720,000 | 33,720,000 |
| 06 | 1006156 | 05 | 4430 | 6020000 | 3535 | 90603AA | 2,000,000 | 2,000,000 |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 6050000 | 3535 | 90603AA | 1,000,000 | 1,000,000 |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 6060000 | 3536 | 90603AA | 80,000 | 680,000 |
| **TOTALI SHPENZIME KORENTE (KAP 05 + Kap 01)** | | | | | | | **234,370,000** | **234,970,000** |
| **II. SHPENZIME KAPITALE FINANCIM I BRENDSHËM (KAP 01)** | | | | | | | | |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 2310000 | 3535 | 25AG801 | 2,971,200 | 2,971,200 |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 2310000 | 3535 | 25AG802 | 5,028,800 | 5,028,800 |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 2310000 | 3535 | 25AG803 | 2,000,000 | 2,000,000 |
| ***TOTALI SHPENZIME KAPITALE FINANCIM I BRENDSHËM (KAP 01)*** | | | | | | | **10,000,000** | **10,000,000** |
| **TOTALI SHPENZIME BUXHETORE(KAP 01+KAP 05)** | | | | | | | **244,370,000** | **244,970,000** |
| **III. SHPENZIME KAPITALE FINANCIM I HUAJ (KAP 02)** | | | | | | | | |
| 06 | 1006156 | 02 | 4430 | 2310000 | 3535 | 25AD501 | 5,985,676 | 5,985,676 |
| 06 | 1006156 | 01 | 4430 | 2310000 | 3535 | 25AD502 | 11,508,324 | 11,508,324 |
| **TOTALI SHPENZIME KAPITALE FINANCIM I HUAJ (KAP 02)** | | | | | | | **17,494,000** | **17,494,000** |
| **TOTALI SHPENZIME BUXHETORE (KAP 01 + KAP 05 + KAP 02)** | | | | | | | **261,864,000** | **262,464,000** |

Me ardhjen e planit të shpenzimeve buxhetore të vitit 2026 është bërë detajimi i zërave të shpenzimeve sipas planit të mësipërm dhe është ndjekur realizimi i tyre deri tani.
Gjatë kësaj periudhe në buxhetin e miratuar kemi reflektuar ndryshimet e ndodhura në planin e shpenzimeve sipas aktit të cituar më sipër dhe është ndjekur e ndiqet realizimi i shpenzimeve brenda kufijve të miratura të tyre.

- **Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore në nivel produkti.**

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është pjesë e programit është pjesë e programit me kod 04430 Mbështetje për Burimet Natyrore me kod 04430 dhe të gjitha veprimet i kryen nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, (neni 15 i Ligjit Nr. 115/2015) ky institucion financohet nga Buxheti vjetor i shtetit (Kapitulli 01) dhe nga të ardhurat e shërbimeve me të tretët (kapitulli 05). Gjithashtu bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 115/2015, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar merr pjesë pas miratimit në ministri në projekte brenda dhe jashtë vendit, financimet e të cilave mbulojne shpenzimet për realizimin e këtyre projekteve dhe i jane akorduar institucionit tonë si Grante, Kapitulli 06 për projektet që janë në vazhdim dhe tek Financimi i Huaj Kapitulli 02 për projektet e reja të financimit te huaj.

Numri i punonjeve të planifikuar për vitin 2026 është 126 punonjës gjithsej, nga këto: 116 punonjës në organikën e miratuar të institucionit me Urdhërin e Kryeministrit nr. 91 datë 31.08.2023 "*Për miratimin e strukturës dhe oragnikës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*"; 9 punonjës me kontratë të përkohshme pune sipas shkresës së MIE nr 717/2 prot, datë 09.02.2026 dhe një punonjës me kontratë pune në kuadër të Programit Kombëtar të Praktivave të Punës.

Numri faktik i punonjësve të institucionit tonë në fund të 4 mujorit 2026 është 105 punonjës gjithsej , 97 punonjës në organikë (nga këto një pozicion i plotësuar me programin e ekselencës) dhe 7 punonjës me kontratë të përkohshme pune dhe 1 punonjës në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.
Pozicione të paplotësuara në fund të 4 mujorit 2026, janë 19 (gjashtembedhjetë) pozicione nëpunës në shërbimin civil dhe 2 (dy) punonjës me kontratë të përkohshme pune.

Numri faktik i punonjësve (organika+kontrata) është 105 punonjës gjithsej, nga këto punonjës femra janë 45.71 % (ose 48 punonjës) dhe punonjës meshkuj 54.29% (ose 57 punonjës).

Numri faktik i punonjësve në organikë është më i vogël se numri i planifikuar i tyre për shkak të vakancave të krijuara e mosplotësimit të tyre.

Gjatë periudhës 1 janar-30 Prill 2025 kemi patur në total 1(një) rast të daljes së punonjesve në pension pleqërie ;1 (një) rast dorëheqje nga puna dhe 1 (një) rast pezullim nga puna për një periudhë dyvjeçare.
Gjatë këssaj periudhe kemi emerime të reja 3 (tre) nëpunës me procedurë pranim në shërbimin civil dhe 7 (shtatë) punonjës në pozicionin Përgjegjës sektori me procedurë ngritje ngritje në detyrë.

Kriteret dhe kërkesat e posaçme të pozicioneve vakante te vitit 2026 janë dërguar në DAP dhe kanë filluar procedurat për zëvendësimin 18 pozicioneve vakante specialistë, të cilat janë në vazhdim dhe nuk kanë përfunduar procedurat akoma.

- **Performanca e buxhetit në nivelin e programit.**

Realizimi i shpenzimeve buxhetore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar sipas zërave të planifikuar për vitin 2026 paraqitet është si më poshtë:

| *Kodi i Produktit* | *Emërtimi i Produktit* | *Artikujt Buxhetor* | *Plani fillestar* | *Plani i rishikuar* | *Fakti* | *% realizimit krahasuar me planin vjetor* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **I. Shpenzime korente** | | | | | | |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Pagat (kap 01) | 164,950,000 | 164,950,000 | 47,795,144 | 28.98 |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Pagat (kap 05) | 4,400,000 | 4,400,000 | 679,341 | 15.44 |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Kontrib.e Sigu Shoqërore (kap 01) | 27,470,000 | 27,470,000 | 7,836,013 | 28.53 |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Kontrib.e Sig Shoqërore (kap 05) | 750,000 | 750,000 | 119,229 | 15.90 |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Mallra e Shërbime (Kap 01) | 33,720,000 | 33,720,000 | 6,004,778 | 17.81 |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Mallra dhe Shërbime (Kap 05) | 2,000,000 | 2,000,000 | 264,000 | 13.20 |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Transfer.Korrente të Huaja (Kap 01) | 1,000,000 | 1,000,000 | 999,943 | 99.99 |
| 90603AA | Administrate funksionale per aktivitetin e ShGjSh | Transferta për Buxhetet Familj e Ind. (kap 01) | 80,000 | 680,000 | 192,616 | 28.33 |
| | ***Totali shpenzime korente (Kap 01)*** | | ***234,370,000*** | ***234,970,000*** | ***63,891,064*** | 27.19 |
| **II. Shpenzime për investime me financim të brendshëm** | | | | | | |
| 25AG801 | Blerje pajisje teknologjike ShGjSh | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara (kap 01) | 2,971,200 | 2,971,200 | 2,971,200 | 100.00 |
| 25AG802 | Blerje pajisje teknologjike ShGjSh | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara (kap 01) | 5,028,800 | 5,028,800 | 0 | 0.00 |
| 25AG803 | Blerje pajisje kompjuterike ShGjSh | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara (kap 01) | 2,000,000 | 2,000,000 | 0 | 0.00 |
| | ***Totali shpenzime kapitale (Kap 01)*** | | ***10,000,000*** | ***10,000,000*** | ***2,971,200*** | **29.71** |
| **Totali shpenzime buxhetore (kap 01+kap 05)** | | | **244,370,000.00** | **244,970,000.00** | **66,862,264.00** | 27.29 |
| **III. Shpenzime për investime me financim të huaj** | | | | | | |
| 25AD501 | Pojekti AIMS | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara (kap 02) | 5,985,676 | 5,985,676 | 0 | 0.00 |
| 25AD502 | Pojekti Rispect | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara (kap 02) | 11,508,324 | 11,508,324 | 0 | 0.00 |
| | ***Totali shpenzime kapitale (Kap 02)*** | | **17,494,000** | **17,494,000** | ***0*** | 0.00 |
| **Totali shpenzime buxhetore (kap 01 + kap 05 + KAP 02)** | | | **261,864,000.00** | **262,464,000.00** | **66,862,264.00** | 25.47 |

Realizimi total i shpenzimeve buxhetore (korente + kapitale) për katërmujorin 2026 krahasuar me planin vjetor të miratuar është 25.47 %.

Janë shlyer kryesisht detyrimet e institucionit tonë për paga e kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetsore, për detyrime ndaj shtetit, për ujë, energji elektrike, shërbim me roje private, postë, etj. dhe nuk kemi detyrime të prapambetura ose detyrime të reja të krijuara dhe të palikujduara.

Realizimi i shpenzimeve korente për katërmujorin, krahasuar me planin e miratuar të tyre është 27.19 %; realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm është 29.71%; ndërsa realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj është 0 %.
Shpenzimet e realizuara gjatë kësaj periudhe janë sipas planit të miratuar të tyre dhe janë kryesisht shpenzimet për furnizimin me energji, ujë, për ruajtjen e objekteve, shpenzime për punën në terren e të tjera shpenzime të domosdoshme për mirëfunksionimin e institucionit.
Realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat e krijuara është i lidhur me shpenzimet që bëhen për realizimin e këtyre të ardhurave dhe kërkesat për shërbimet për të tretët që kanë nevojë për shpenzime.

**Fondi i veçantë** i akorduar per vitin 2026, sipas shkresës të permendur sa me sipër eshte ne shumen totale 600.000 lekë. Perdorimi i tij gjate vitit 2026 eshte ne shumën totale lekë, per 1 rast të daljes në pension është në shumën totale 149.160 lekë dhe për një rast semundje të punojësit në shumën 50.000 leke.

Gjate vitit 2026, institucioni ynë ka punuar përveç projekteve dhe detyrave të përcaktuara në Programin Zhvillimor edhe në projekte te tjera të cilat janë me finacim të huaj (Grante të BE) dhe nga financime te tjera nga institucione brenda vendit (Kapitulli 06 Të ardhura jashtë limitit).
Për projektet me finacim të tjera të kapitullit 06, nga organizma jashtë e brenda vendit (grante), janë fondet e trashëguara nga viti 2025për këto projekte (grante) që institucioni ynë vazhdon e i realizon në vitin 2026 dhe gjithashtu do të pasqyrohen në çeljet e kësteve e financimit të këtyre projekteve gjatë vitit 2026.

Projektet me finacim të tjera të kapitullit 06 i kemi me dy burime financimi e konkretisht:

***a) Projekte të financuara nga jashtë vendit (grante nga BE),***

Gjatë tetërmujorit, janë ndjekur fondet dhe shpenzimet sipas planit të miratuar të tyre për 2 projekte me financin nga jashë vendit. Fondet në dispozicion për vitin 2026 dhe realizimi i katërmujorit për projekte me financim të huaja (grante), i përmbledhur jepet në tabelën e mëposhtme:

| NR | Emërtimi i projekteve | TOTALI | |
|---|---|---|---|
| | | Fonde të trashëguara +çelje | Shpenzime të realizuara |
| 1 | PROJEKTI EMODNET "Rrjeti Europian i të dhënave dhe observimeve detare". | 6,139,634 | 272,119 |
| 2 | PROJEKTI "GSEU" "Një Shërbim Gjeologjik për Europën" | 2,018,454 | 33,700 |
| | **TOTALI I FINANCIMIT TE HUAJ** | **8,158,088** | **305,819** |

Projekti EMODNET dhe projekti GSEU, janë projekte që do i vazhdojnë aktivitetet e tyre gjatë vitit 2026 dhe e vazhdim. Shpenzimet për projektet me finacime nga jashte realizohen në përputhje me planet e miratuara të financimit sipas kontratave të nënshkruara dhe financimet e dhëna nga donatorët e tyre dhe do te ndiqet realizimi i tyre sipas planit të miratuar të tyre e financimeve nga donatorët në periudhën ne vazhdim.
Shpenzimet kapitale të planifikuara për projektin Emodnet për vitin 2026 janë për blerje automjet elektrik për nevoja të realizimit të objektivave të këtij projekti dhe detyrave të tjera të institucionit. Për këtë procedurë ka përfunduar hartimi i dokumentacionit dhe procedura është në OPB në fazën e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatoret pjesëmarrës në këtë procedurë.

b) ***Projekte me financim brenda vendit.***

Për vitin 2026 kemi një projekt me financim nga institucione brenda vendit, konkretisht është financuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Tiranë, Kontrata e Shërbimit me titull "*Matja e prurjeve ujore në lumenjtë e Shqipërisë për vitin 2026*", me nr. 486/3 prot, datë 10.04.2026 të institucionit tone dhe nr 4255/3 prot, datë 10.04.2026 të AKM. Shpenzimet për këtë projekt kryhen sipas kësaj kontrate dhe financimeve të dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Fondet në dispozicion dhe realizimi i tetëmujorit për këtë projekt është i përmbledhur dhe jepet në tabelën e mëposhtme:

| Nr.sipas preventivit | Preventivi sipas kontratës | Preventivi sipas kontratës | Fondi i çelur | Realizimi faktik |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Dieta | 1.270.180 | | 0 |
| 2 | Karburant | 192.280 | 152.130 | 0 |
| 3 | Shpenzime për mirëmbajtje automjeti | 28.842 | | 0 |
| 4 | Kancelari | 30.000 | | 0 |
| | TOTALI | 1.521.302 | 152.130 | 0 |

Shpenzimet për këtë kontratë janë shpenzime operative për punë në terren për përmbushjen e objektivave të realizuara e të tjera shpenzime operative si kancelari e mjete të tjera të nevojshme për realizimin e saj dhe do të ndiqet realizimi i saj sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

- **<u>Projektet kapitale</u>**

***a) Nga buxheti i shtetit***

Fondet për investime kapitale buxhetore të planifikuara me financime të brendshme për vitin 2026 janë dërguar me shkresën e MIE me nr. 137/4 prot, datë 25.03.2026 *"Dërgohet miratimi i detajimit të buxhetit për shpenzimet kapitale për vitet 2026-2028 "*.
Fondet e planifikuara:

### a) *Projekte kapitale me financim të brendshëm.*

Fondet e planifikuara për projektet me financim të brendshëm janë në shumën 10.000.000 lekë dhe janë planifikuar për vitin 2026 këto tre projekte:

1. Projekti me kod 25AG801 me titull "*Blerje aparatura e paisje pune profesionale për Laboratorin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (kontratë e lidhur në vitin 2025)*", me vlerë 2.971.200 lekë. Ky project ishte planifikuar për vitin 2025, procedura e prokurimit nga Operatori i Blerjeve te Perqendruara, p{rfundoi ne fund te vitit 2025, sipas kontratës për blerjen e paisjeve laboratorike më datë 24/12/2025 me nr, 675/28 Prot. Ky projekt ka përfunduar dhe është realizuar në masën 100 %.

2. Projekti me kod 25AG802 me titull "*Blerje aparatura e paisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*" me vlerë 5.028.800 lekë. Për këtë project nuk ka filluar akoma procedura e prokurimit por është përcaktuar lista e paisjeve që do të blihen dhe do të fillojnë së shpejti procedura e pregatitjes së dokumentacionit për ta dërguar për fillimin e procedures së prokurimit.

3. Projekti me kod 25AG803 me titull "*Blerje paisje kompjuterike për nevoja të ShGjSh*" me vlerë 2.000.000 lekë. Është përcaktuar lista e paisjeve kompjuterike të nevojshme dhe jemi në fazën e hartimit të specifikimeve teknike dhe argumentimit të fondit limit, për t'i dërguar pranë OPB për vazhdimin e procedures së prokurimit.

### b) *Projekte kapitale me financime te huaja*

Fondet e planifikuara për projektet me financim të huaj janë në shumën 17.494.000 lekë dhe janë planifikuar për vitin 2026 këto dy projekte:

1. Projekti me kod 25AD501 me akronim AIMS me titull "*Zhvillimi dhe testimi i një modeli parashikues të përbashkët, të bazuar në AI për një përdorim të koordinuar të të dhënave të mëdha (big data) dhe për një Sistem të përbashkët Monitorimi të rrezikut të rrëshqitjeve në rajonin Adriatik-Jon*" ("*Development and testing of a shared, AI-based predictive model for a coordinated use of big data and for a joint Monitoring System of landslides risk in the Adriatic-Ionian region*"); Programi i IPA ADRION00414 (INTERREG VI-B) IPA Adriatic Ioanian Cooperation Programme;. me vlerë 5.985.676 lekë.

Deri tani ky projekt ka raportuar tek lideri i projektit vetem kostot e punës të stafit të përfshirë në realizimin e aktiviteteve te planifikuara. Me hapjen e kodit të vecantë të këtij produkteve, sipas klasifikimit buxhetor në kapitullin 02 "*Financim i huaj*" në fillim të vitit 2026 është berë çelja e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë.
Puna për këtë projekt ka vazhduar sipas komunikimeve me liderin e projektit dhe gjatë muajit maj 2026 grupi përfaqësues i institucionit tonë do të marrë pjesë në një takim pune që do të zhvillohet jashtë vendit, por deri më 30.04.2026 nuk kemi shpenzime të likujduara për këtë projekt. Gjatë periudhës në vazhdim do të ndiqet realizimi i gjithë fondeve të akorduara për këtë projekt në përputhje me zërat e miratuara të shpenzimeve sipas dokumentit të këtij projekti.